



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

U R D H Ë R

Nr.124, datë 18.9.2019

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS
PËR HARTIMIN E PAKETËS LIGJORE PËR GARANTIMIN
E TË DREJTËS SË VOTËS PËR SHTETASIT SHQIPTARË JASHTË
TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të shkronjës “F”, të pikës 3, të vendimit nr.510, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Diasporën”,

U R D H Ë R O J:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga ministri i Shtetit për Diasporën dhe në përbërje të tij të ketë anëtarë, përfaqësues nga institucionet, si më poshtë vijon:
 - a) Ministria e Brendshme;
 - b) Ministria e Drejtësisë;
 - c) Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
 - ç) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
 - d) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - dh) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
 - e) Instituti i Statistikave.



3. Grupi ndërinstitutional i punës të bashkëpunojë me Komisionin e Reformës Zgjedhore në Kuvendin e Shqipërisë. Ai koordinon punën me Komisionin e Reformës Zgjedhore dhe u përgjigjet në emër të Kryeministrit kërkesave të punës bashkëpunuese, të cilat lidhen me realizimin e qëllimit të këtij urdhri.
4. Metodologjia e hartimit të paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bazohet në rekomandimet e Bashkimit Evropian për këtë qëllim, si dhe në praktikatat dhe modelet më të mira të vendeve anëtare të tij.
5. Në hartimin e paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, grupi ndërinstitutional i punës mund të kryejë konsultime e të marrë mbështetje nga përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë të jashtëm apo përfaqësues të organizatave ndërkombëtare.
6. Paketa me ndryshime ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të hartohet e të paraqitet për miratim në Këshillin e Ministrave, brenda muajit dhjetor 2019.
7. Ngarkohen titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, të dërgojnë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij, emrat e përfaqësuesve të tyre pranë ministrit të Shtetit për Diasporën.
8. Ngarkohet ministri i Shtetit për Diasporën që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të sigurojë fillimin e veprimtarisë së grupit ndërinstitutional të punës.
9. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe të gjitha institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA